



INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE



RELACION TEKNIK

Vasll
Polo

Digitally signed by Vasll
Polo
Date: 2024.11.08
11:00:00 +0200

Mbi

Projektin e Restaurimit
“Teqeja e Koshtanit”, Koshtan_Memaliaj

Punoi: Ark. Arbjona BALA

Ark. Ronela ÇUKU

Ing. Vaso POLO

MIRATOHET

PËR K.K.T.K.M.

SEKRETARI

SOKOL ISMAILI



TIRANË Qershor 2024



PËRMBAJTJA:

1. VENDNDODHJA.....	2
2. ANALIZA HISTORIKO –ARKITEKTONIKE.....	3 - 4
- Të Dhënat Historike.....	3
- Analiza Arkitektonike.....	3
- Bibliografia.....	4
- Fazat e ndërtimit të kishës.....	6
- Rilevime të vjetra nga Arkivi i IKTK.....	7
- Foto gjendja ekzistuese.....	7
3. NDËRHJRJET NDËR VITE.....	7
4. GJENDJA E KONSERVIMIT.....	8
5. NDËRHJRJET RESTAURUESE TË PARASHIKUARA.....	15

Vasli
Polo

Digitally signed by Vasli
Polo
Date: 2024.06.11
11:07:28 +0300

Arbana
Bala



Vendndodhja:

Teqeja e Koshtanit ndodhet në fshatin Koshtan, rreth 20 km nga qyteti i Memaliajt. Teqeja është e pozicionuar ne nje terren kodrinor ne hyrje te fshtatit dhe e distancuar prej tij.




Fig 1 "Foto ajrore, pozicionimi ne harte"



Fig 2 "Foto ajrore e Teqesë së Koshtanit"

ANALIZA HISTORIKO – ARKITEKTONIKE

ANALIZA HISTORIKE

E enjtja e 15 tetorit 2020, shënon 213-vjetorin e teqesë së njohur të Koshtanit në Tepelenë, një nga objektet e rëndësishme të këtij kulti jo vetëm në Shqipëri, por në rajon e më gjerë. Kjo teqe, zë një vend të rëndësishëm në historinë mbi tetë shekulle të tarikatit të paqtë bektashian, jo vetëm si një qendër e edukimit të besimtarëve e përhapjen e këtij besimin në Jugun e Shqipërisë, por dhe si një qendër atdhetare dhe e arsimimit

shqip.

Teqeja e Koshtanit, ka një konstrukt të veçantë si objekt, me dhoma të bollshme, mejdanin, dhomën e pritjes e bisedave, ashefin, kuzhinën, mensën, dhomat e fjetjes etj, ka qenë në kohëra edhe një qendër e pasur ekonomike. Më 15 tetor të vitit 1908, në këtë teqe, është çelur e para shkollë shqipe për Tepelenën. Madje, në kushtet ilegale të zhvillimit të arsimit shqiptar, në vitet më pas, në bankat e shkollës së teqesë u ulën nxënës jo vetëm nga Tepelena, por edhe Vlora, Mallakastra e Përmeti.

Sipas dokumenteve, kjo teqe me emër është themeluar në vitin 1807 prej baba Sadikut me origjinë nga Turballia e Greqisë, i ndihmuar ky dhe nga baba Shememi Babai i Krujës. Ajo ka qenë një qendër e rëndësishme në krahinën e Tepelenës, krahas përhapjes së bektashizmit, por edhe për rolin që ka luajtur në Rilindjen Kombëtare Shqiptare nëpërmjet aktivitetit të baballarëve të shquar si, baba Ahmedi, baba Kasua, baba Nurja, që janë ndër klerikët e parë që e drejtuan këtë teqe dhe kanë lënë gjurmë në historikun e saj. Aktiviteti i tyre fetar e atdhetar vazhdoi dhe më pas nga klerikët që drejtuan si: baba Muharremi, baba Ismaili, baba Shefqeti Gllava, baba Abedin Greshica, dervish Muharrem Zhapokika, dervish Ibrahim Zhapokika; baba Abedin Agaj me dervish Hysen Merdani, dervish Demir Xhakaj, dervish Xhafer Sinamemaj, dervish Hamza Xhelilaj, baba Adem Maksutaj, (deri në vitin 1963) dhe, në vitin 1967 me baba Myrteza Tinari, dervish Myrteza Kamberi, baba Lutfi Memushaj, dervish Xhafer Sinomemaj. Marsi i vitit 1967 shënon dhe mbylljen e kësaj teqeje me emër,




mbi bazqën e vendimit shtetëror të kohës që ndaloi me ligj ushtrimin e besimeve fetare në Shqipëri dhe ushtrimin e aktivitetit të objekteve të kulteve. Baballarët që vazhduan më pas dhe ringritja mbas vitit 1990 me baba Abdyl Shehun, teqeja ruan traditën bektashiane dhe qëndron si një kështjellë monument i historisë kombëtare.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për Teqenë e Koshtanit, ndër të tjera pohon: *"...15 tetori mbart brenda vetes një simbolikë të veçantë. Në tetor të vitit 1908, dyert e drunjta të kësaj teqeje, ato dyer aq të dashura për mijëra besimtarë jo vetëm nga Tepelena por edhe Mallakastër, Gjirokastra, Vlora e Përmeti, u çelën për nxënësit e të parës shkollë shqipe në këtë trevë. Së bashku me dijet për Zotin, nxënësit e atij shekulli aq të trazuar për Shqipërinë, do të mësonin dijet e historisë, gjeografisë dhe gjuhës së bukur shqipe, e cila ndonëse e lindur pesë shekuj më parë, ishte sulmuar aq barbarisht nga otomanët dhe të tjerë. Tanimë, nga historiografia jonë por edhe nga ajo Evropiane, është pohuar gojëplotë fakti se gjatë periudhës së lëvizjes autonomiste shqiptare, teqetë bektashiane u shndërruan në vatra të përhapjes dhe mësimit të gjuhës shqipe. Librat e Haxhi Bektash Veliut ishin dhe mbetën të bashkuar në sepetet e baballarëve tanë, duke dëshmuar se Zoti dhe kombi nuk mund të mohohen. Kjo devizë madhështore ka mbrojtur jo vetëm mendimin por edhe veprimin bektashian të atyre viteve. Është folur shumë ndërkaq edhe për përpjekjet e baballarëve tanë për alfabetin me germa latine, madje disa prej tyre dhanë jetën për libra me alfabet të tillë. Nëse e kthejmë vështrimin pas në ato kohëra, shohim qartë se lëvizja jonë atdhetare kombëtare në bashkëpunim me institucionet bektashiane, e kishte të qartë se fatet e atdheut vendoseshin me pushkë dhe penë. Ata ishin të ndërgjegjshëm gjithashtu se gjuha shqipe, largimi ynë i gjithë kohshëm nga zgjedha otomane, do të ishte shenja më domethënëse për t'iu afruar familjes natyrore Evropiane, të cilës i përkisnim në të vërtetë. Teqeja e Koshtanit ishte vënë plotësisht në funksion të shqiptarizmit, prandaj ajo u dogj dy herë, nga andartët grekë dhe forcat esadiste, ndërsa dervishët dhe baballarët e saj u burgosën dhe u vranë..."*

Referencat - Bibliografia

P. Borici - Nuri Çuni



ANALIZA ARKITEKTONIKE

Pasuria Kulturore "Teqja e Koshtanit" është Monument Kulture kat. I-rë, shpallur nga M.T.K.R.S. (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore) nr. 503, dt. 06.09.2006. Teqja e Koshtanit është një objekt kulti që i përket fillimit të shekullit XIX. Ndërtesa është 2 katëshe. Në hyrjen e madhe të rrethimit të Teqesë ndodhet busti i Heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, ndërsa në oborrin e saj përballë hyrjes kryesore ndodhet busti i Baba Muharremit.

Teqja në hyrjen kryesore ka një ballkon i cili është dy katësh dhe për në katin e dytë ngjitesh me një palë shkallë guri që janë jashtë ballkonit si dhe një palë shkallë druri që janë në ambjentin e brendshëm të saj. Ballkoni egzistues është ndërtuar në vitin 2009 dhe është i punuar me harqe dhe ka kupolë në krye.

Në katin e parë Teqja ka si ambiente të brendshme 3 (tre) dhoma dhe 1 koridor. Dy prej dhomave shërbejnë për pritje dhe njëra është guzhinë. Nga brenda dhomat janë të suvatuara dhe të lyera me bojë ngjyrë të bardhë.

Në katin e dytë ka si ambiente të brendshme 1 (një) dhomë pritjeje, dhoma e Babait, Faltorja (Mejdani) dhe koridori. Edhe ambjenti i katit të dytë nga brenda është e suvatur. Tavanet e katit të dytë janë me dru dhe të zbukuruar. Çatia është e mbuluar me rrasa guri të zeza. Dyert kryesore në të dy katet janë të punuara me hark, ndërsa dritaret kanë formë kuadratiqe. **Dhomat nga brenda kanë ndarje të thjeshta në formë katërkëndore.**

Për ndërtimin e mureve janë përdorur gurë të punuar, të vendosur në rreshta horizontal dhe të lidhur me llaç balte dhe gëlqereje. Gurët kanë formë të rregullt drejtkëndore dhe me madhësi mesatare.

Referencat - Bibliografia

Autorët e projektit – studimi i pasurisë "in situ"



FAZAT E NDËRTIMIT TË KISHËS

Duke qene se Teqja e Koshtanit është shpallur vonë pasuri kulturore në vitin 2006, përse i përket datimit të saktë të ndërtimit dhe kompozimit fillestar arkitektonik të kësaj pasurie kulturore nuk ka një informacion zyrtar, duke qenë se mungojnë të dhëna fotografike, përshkrimore/bibliografike nga studiues të mirëfilltë historianë apo teknikë të fushes së trashëgimisë kulturore materiale.

Por, duke l'u referuar formës së kryqit në plan, për një objekt të kultit musliman është një element arkitektonik i pazakontë. Kjo të lë të kuptosh që në fillimet e veta objekti të ketë patur një formë T në plan, duke qenë se ky objekt ka shërbyer edhe si një qendër e edukimit të besimtarëve bektashian dhe më vonë si një qendër atdhetare dhe e arsimimit në gjuhën shqipe. Në këtë fazë, ngjitja për një katin e dytë të ndërtesës realizohej nëpërmjet shkallës së brendshme dhe të vetme prej druri. Më vonë në vitin 2009 (referuar një publikimi nga Baba Nuri Cunit) citohet se teqesë i është shtuar ambjenti i jashtëm në formën e një ballkoni të mbuluar me kupolë, volum ky që sjell edhe ndryshimin në planimetri të teqesë nga një T në formën e një kryqi.




Fig 3 "Fazat e ndërtimit te teqese"

RILEVIME TË VJETRA NGA ARKIVI I IKTK-SË

Duke qenë se Teqja e Koshtanit është shpallur monument kulture në vitin 2006, në Arkivin e IKTK-së nuk ka rievime apo foto të vjetra të kësaj pasurie kulturore.

Rilevimet për hartimin e projektit të restaurimit janë kryer në objekt nga grupi i specialistëve të IKTK-së dhe DRTK Gjirokastrë.


NDËRHRYJET NDËR VITE

Nga shqyrtimi i dosjes së monumentit në Arkivin e IKTK-së, nuk rezulton të ketë një projekt restaurimi të miratuar apo materiale të depozituara përsa i përket ndërhyrjeve restauruese ndër vite për Teqenë e Koshtanit.

GJENDJA E KONSERVIMIT

Nga inspektimi i realizuar nga specialistët e IKTK-së dhe DRTK Gjirokastrë në terren, u konstatua se përgjithësisht objekti ruhet në gjendje të mirë strukturore, me përjashtim të një çarje vertikale në muraturën e faqes jugore e cila kërkon përforsim të themelit të gurit. Në mënyrë të përmblendhur problematikat konsistojnë në:

- Presencë bimësi e ulët e mbirë në ambjentin përreth objektit;
- Prezencë patinë biologjike në fasadën prej guri;
- Çarje vertikale të arkitrarëve të gurit sipër dritareve;
- Degradim i dyerve/dritareve të drurit;
- Ndërhyrje të gabuara ndër vite, vendosje dritare durali në fasade, lyerje e fasadës së gurit me gëlqere;
- Dëmtim i paretit të jashtëm të muraturës prej guri;
- Çarje vertikale në muraturën prej guri;
- Degradim/shplarje i llaçit lidhës në muraturë;
- Dalje nga vertikaliteti i muraturës prej guri në fasadë;
- Ndërhyrje e gabuar, vendosje arkitra druri sipër dritares në fasade;



- Dysheme llustër çimento e degraduar e ambienteve të brendshme të katit përdhe;
- Degradim i shkallës së drurit në brendësi të objektit;
- Degradim i dyshemesë së drurit në katin e sipërm të objektit;
- Tavan plastik i degraduar;
- Muraturë jo e rregullt e ambientit të tualetit;
- Dëmtim i soletës prej b/a;
- Degradim i çatisë me rrasa guri;

FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE (Qershor 2024)



Fig 4 “Foto ajrore e Teqese se Koshtanit”



Fig 5 "Foto ajrore, Fasada perendimore e Teqese se Koshtanit"



Fig 6 "Foto ajrore, Fasada veriore-perendimore e Teqese se Koshtanit"



Fig 7 "Foto ajrore, Fasada jugor-lindore e Teqese se Koshtanit"



Fig 8 "Fasada jugore e Teqese se Koshtanit"






Fig 9 "Fasada veriore e Teqese se Koshtanit"



Fig 10 "Fasada veriore e Teqese se Koshtanit"





Fig 11 "Fasada perendimore e Teqese se Koshtanit"



Fig 12 "Ambjent ndenjeje kati perdhe"






Fig 13 "Shkalle e brendshme prej druri"




Fig 14 "Ambjent ndenjeje kati perdhe"




Fig 15 "Foto e magazines ne katin perdhe"




Fig 15 "Tualeti I katin te pare teknik"



Fig 16 "Ambjent ndenjeje kati I pare teknik"





Fig 17 "Ambjent ndenjeje kati I pare teknik"



NDËRHJRJET RESTAURUESE TË PARASHIKUARA

Duke parë dhe vlerësuar situatën specialistët propozojnë ndërhyrjet si më poshtë:

- Pastrim nga bimësia e ulët + injektim i solucionit për tharjen e bimëve të këqija përreth monumentit;
- Pastrim i patinës biologjike në fasadën prej guri;
- Çmontim i dritareve durali, F.V. dyer, dritare druri;
- Pastrim fasade mur guri, Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim)
- Restaurim mur guri me llaç gëlqere me teknikën shqep-qep;
- Fugatim murature në fasadë, konsolidim strukturor i muraturës prej guri me dy parete me mbushje në mes, me teknikën e injektimit të mishelës me presencë të lartë mekanike dhe përberje të ulët të kriprave të tretshme në ujë;
- Injektim i çarjeve gjatësore në muraturë me teknikën e injektimit (pastrim i çarjes, larje me ujë, injektim llaç gëlqere 1:3);
- Përforcimi i themelit të gurit me jastik b/a në faqen jugore të objektit;
- Çmontim arkitra druri sipër dritares, F.V. arkitra druri;
- Përforcim arkitra guri me elementë metalikë;
- Shtrim me dysHEME druri i katit përdhe të objektit;
- Restaurim dysHEME, shkallë druri;
- Çmontim tavan plastik në katin përdhe, ndërtim tavan i thjeshtë druri;
- Çmontim i muraturës së katit të parë teknik të tualetit, ndërtim mur guri llaç gëlqere 1:2;
- Çmontim i të dyjave soletave b/a të tualeteve, ndërtim soletë b/a për ndërkatin dhe ndërtim çatie rrasa guri sipër ambjentit të tualetit të katit të parë teknik;
- Riparim, ritukim i suvasë së brendshme të ambjenteve të ndenjës;
- Suvatim llaç gëlqere i tavanit me strukturë të kurbëzuar (kupolë) në hyrje të katit të sipërm;
- Restaurim i çatisë me rrasa guri me strukturë druri;



Projekt Restaurimi- "Teqja e Koshtanit", Koshtan, Memaliaj

- Çmontim, zbritje, sistemim, seleksionim rrasa guri me pastrim i çatisë në hyrje të objektit me strukturë të kurbëzuar, si dhe montim, plotësim çatie me rrasa guri;
- Lyerje me antimol, vaj lini i elementëve drusorë ekzistues në interior;

Vasili
Polo

Digitally signed by Vasili Polo
Date: 2024.09.11
11:27:20 +0200

Arbena
Bala

Ronela

Digitally signed by
Ronela Cuku
Date: 2024.09.16
11:05:41 +0200

